

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDARDEVE

PROGRAMI I EDUKIMIT TEKNOLOGJIK

KLASA VI

Tiranë, 2005

HYRJE

1. NATYRA DHE QËLLIMET E PËRGJITHSHME

Teknologjia është përdorimi krijues dhe i qëllimtë i njohurive njerëzore, aftësive dhe burimeve fizike për zgjidhjen e problemeve praktike. Teknologjia përshkon jetën tonë të përditshme në familje, punë e kudo gjetkë. Ajo përfshin zhvillimin e objekteve, të sistemeve ose të mjediseve.

Të gjithë nxënësit kanë nevojë të zhvillojnë aftësitë teknologjike dhe kuptimet që i përkasin botës në të cilën ata jetojnë. Edukimi teknologjik ndihmon të zhvillohen tek ta kërkesa për t'u përshtatur në një botë të ndryshimeve të shpejta.

Nxënësit do të zhvillojnë një kuptim të rrugëve në të cilat teknologjia është formuar dhe vazhdon të formohet nga shoqëria. Ata do të mësojnë se teknologjia ka ndikuar në mënyrën e jetesës së njerzve dhe se njerëzit kanë zhvilluar dhe kanë përdorur teknologjitë për të plotësuar nevojat e tyre, duke pasuruar dhe duke thelluar njohuritë e aftësitë që kanë marrë në ciklin fillor. Ata do të zhvillojnë njohuri për ndikimet e teknologjisë në mjedis.

Nxënësit do të ndihmohen të marrin vendime të menduara rreth përdorimit të teknologjisë në lidhje me shoqërinë, mjedisin dhe ekonominë. Ata do të mësojnë të vlerësojnë kostot potenciale dhe përfitimet prej llojeve të teknologjive të përdorura. Nxënësit, gjithashtu, do të zhvillojnë njohuritë rreth llojeve të teknologjive të realizuara, rrugët në të cilat ato operojnë dhe përdorimet që gjejnë. Ata do të zhvillojnë kompetencën në një radhë teknologjish, si dhe aftësinë e të përshtaturit ndaj përdorimit të teknologjive të reja.

Edukimi teknologjik zhvillon një numër të madh aftësish, duke përfshirë ato të zgjidhjes së problemeve, projektimin, ndërtimin, komunikimin, të menduarit kritik, analizën, sintezën dhe vlerësimin.

Kjo fushë e të mësuarit ka lidhje me të gjitha lëndët shkollore, si për shembull, me shkencat e natyrës, matematikën, shkencat shoqërore, vizatimin, artet etj.

Brenda kësaj fushe jepen mundësi të shumta për formimin e nxënësve edhe në drejtim të realizimit të edukimit për karrierën.

Zhvillimi i aftësive për punët e dorës është objektiv fillestar i teknologjisë në moshat e vogla. Në varësi të veprimtarive, duhet punuar për të zhvilluar te nxënësit ndjenjën e arritjes së qëllimit, të rritjes së saktësisë, të shpejtësisë dhe të integritit në botën e punës në nivel shkolle.

Hartimi i këtij programi është bërë në përputhje me ndryshimet cilësore të kurrikulës shkollore.

Edukimi teknologjik përfshin njohuritë dhe shkathtësitë teknologjike, proceset teknologjike, si dhe impaktin e teknologjisë ndaj individit dhe shoqërisë, në të njëjtë kohë. Nëpërmjet këtij edukimi synohet krijimi i shtratit të lidhjes së teknologjisë me shkencat.

Pra, në përgjithësi, ai synon:

1. Promovimin e kapacitetit të nxënësit për të vepruar me frytshmërit në mjedisin teknologjik ku jeton;
2. Nxitja e motivimi i nxënësit për të dhënë ndihmesë në përmirësimin e këtij mjedisi.
3. Përdorimin me frytshmëri të produkteve dhe sistemeve teknologjike.

4. Aftësinë për të vlerësuar produktet teknologjike nga pikëpamja funksionale, ekonomike, mjedisore dhe estetike.
5. Aftësinë për të skicuar dhe për të prodhuar në mënyrë të pavarur disa produkte të thjeshta, të cilat plotësojnë nevoja të caktuara të parashtruara nga vetë nxënësi ose të tjerët.

Këto synime pasqyrohen në:

Veprimtaritë teknologjike që mund të bëhen në shkollë, të jenë, në pjesën më të madhe të tyre, të një natyre praktike. Gjatë këtyre veprimtarive nxënësi fiton përvojë për proceset teknologjike duke skicuar modele, produkte dhe sisteme të thjeshta dhe duke i zbatuar vetë ato. Ndërkohë që zbaton skicat e tij, nxënësi fiton përvojë në përdorimin e instrumenteve të ndryshme që shkonte mund t'i ketë në dispozicion.

Njohuritë, shkathësitë dhe praktika janë të gjitha të harmonizuara në proceset teknologjike dhe kanë lidhje të ndërsjellta ndërmjet tyre. Si rrjedhojë, kurrikuli i edukimit teknologjik të marrë parasysh synimet e njohurive që do të fitojnë nxënësit, si dhe mënyrën më të mirë për ta bërë këtë dhe, në të njëjtën kohë, njohuritë dhe aftësitë që nxënësit marrin përpara pjesës praktike. Kështu, këto njohuri duhet të barten gjatë zbatimeve praktike dhe të shërbejnë për dizejnimin e produkteve apo të sistemeve të veçanta, për vlerësimin e tyre dhe për çdo lloj veprimtarie tjetër të përfshirë në këtë proces.

Linjat e kurrikulit që paraqiten, përfshijnë njohuritë të cilat familjarizojnë nxënësin me disa nga materialet dhe proceset teknologjike të thjeshta që përdoren sot në një shoqëri moderne të teknologjisë së lartë, me struktura të thjeshta ndërtimi, pajisje mekanike, por edhe me ato njohuri e aftësi që lidhen me mjedisin shoqëror, edukimin e shijeve estetike etj. Gjithashtu, kurrikuli kërkon që nxënësit t'i bëhen të njohura sistemet e informimit dhe teknologjia e kompjuterit në mënyrë që të rritet shkalla e tij e ndërgjegjësimit për rolin esencial që ato luajnë në shoqërinë tonë. Nuk është më pak e rëndësishme që detyrat për nxënësit të përfshijnë një numër sa më të gjerë të mundshëm të linjave të teknologjisë.

Një tjetër çështje e edukimit teknologjik është ndikimi i teknologjisë dhe i zhvillimeve teknologjike mbi individin dhe shoqërinë. E kaluara dhe e tashmja mund të shërbejnë si ilustrim i ndihmesës së teknologjisë mbi mirëqënien tonë, si dhe për rreziqet që mbart ky zhvillim, për rolin që luajnë individit dhe shoqëria në zhvillimet teknologjike, si dhe ndikimi i tyre në mjedisin teknologjik.

2. SYNIMET E PERGJITHSHME TË LËNDËS

Synimet e përgjithshme të edukimit teknologjik mbështeten në njohuritë e akumuluar në këtë fushë, në zbatimet e teknologjisë në jetën tonë të përditshme, si dhe në nevojat e nxënësve. Këto synime po i rendisim më poshtë:

Nxënësi duhet:

1. Të marrë njohuri dhe të kuptojë konceptet dhe parimet bazë teknologjike.
2. Të njohë procesin teknologjik dhe të dijë ta zbatojë atë në skicimin e produkteve dhe sistemeve të thjeshta.
3. Të fitojë aftësitë që kërkohen për realizimin e procesit teknologjik.

4. Të zhvillojë të menduarit krijues gjatë veprimtarisë teknologjike. Krijimtaria e tij duhet të pasqyrohet në veprimtaritë të tilla, si: hqyrtimi, zbulimi, skicimi, prodhimi, vënia në punë dhe vlerësimi i produkteve dhe sistemeve.
5. Të nërgjegjësohet për impaktin e teknologjisë ndaj individit dhe shoqërisë, si në të kaluarën dhe në të tashmen.
6. Të kuptojë rolin e dukshëm të individit në shoqëri dhe ndihmesën e tij në ndryshimin e mjedisit në të cilin ai jeton.
7. Të informohet për disa nga fushat më tipike teknologjike dhe t'i shohë ato.
8. Të zhvillojë vetëbesimin, një imazh pozitiv për veten, si dhe krenarinë për arritjet e tij.
9. Të tregojë interes, kuriozitet, intuitë, pavarësi dhe aftësi krijuese gjatë veprimtarisë teknologjike.
10. Të bëjë të vetat qëndrimet pozitive ndaj sektorit të industrisë, punës prodhuese dhe njeriut të punës (punëtorit).
11. Të bashkëpunojë me shokët e klasës dhe të ndajë përgjegjësitë për realizimin e detyrave që i vihen grupit.

3. OBJEKTIVAT QË NXËNËSIT DUHET TË ARRIJNË NË PËRFUNDIM TË SHKOLLËS SË DETYUAR

Për të pasur të qartë drejtimit e kurrikulës së edukimit teknologjik, si dhe vazhdimësinë e kërkesave të përshkallëzuara brenda një cikli, po japim objektivat që duhet të arrijnë nxënësit në përfundim të shkollës së mesme të ulët, ku dhe mbyllet arsimi i detyruar.

Në fund të klasës IX nxënësit duhet:

- të jenë në gjendje të shprehin idetë e tyre dhe të hartojnë planin e punës me ndihmën e mësuesit, të zgjedhin metodat e punës e ta kryejnë atë deri në fund;
- të jenë në gjendje të zgjedhin ngjyrën, formën e materialet që iu nevojiten e të dinë të arsyetojnë zgjedhjen që kanë bërë nën mbikqyrjen e mësuesit;
- të dinë të përdorin veglat e instrumentet e duhura, si dhe të dinë të punojnë në tekstil, dru e metal;
- të dinë të zbatojnë instruksionet që ju jepen, dhe të mbajnë përgjegjësi për punën e tyre;
- të jenë në gjendje të përshkruajnë punën e tyre dhe të komentojnë proceset e ndryshme të punës;
- të jenë në gjendje që nëpërmjet fjalëve e vizatimeve të paraqesin idetë e tyre dhe të planifikojnë punën;
- të dinë të zgjedhin materialin, ngjyrën e formën duke patur parasysh koston, funksionin dhe mjedisin;
- të kenë nisëativë e të mbajnë përgjegjësi për punën e tyre;
- të dinë të përshkruajnë procesin e punës, të argumentojnë e të shpjegojnë veprimet që ata kanë kryer që nga fillimi deri në produktin e gatshëm;
- të dinë të vlerësojnë punën e tyre, ta kenë të qartë si ka ndihmuar kjo punë në produktin e krijuar.

4. AFTËSITË

Gjatë zbatimit të procesit teknologjik (brenda kuadrit të kurrikulit) numërohen një sërë aftësish që duhet të përjetojë nxënësi. Parashikimi i këtyre të fundit në kurrikul i ndihmon mësuesit në formulimin e qëllimeve të mësimdhënies e vlerësimin e arritjeve. Tri janë kategoritë kryesore të listuara më poshtë: aftësitë njohëse, aftësitë praktike dhe aftësitë komunikuese.

Aftësitë njohëse: Përcaktimi i problemeve dhe nevojave njerëzore, vëzhgimi, mbledhja e të dhënave, interpretimi i të dhënave të mbledhura, specifikimi i kërkesave që duhet të përmbushë produkti, zgjidhje e problemeve që lidhen me skicimin e produktit, shqyrtimi dhe vlerësimi i zgjidhjes, krahasimi, dallimi, analiza sipas kriterëve, vendimmarrja.

Aftësitë praktike: Matja, markimi, prerja dhënia e formave, bashkimi dhe montimi, ndërtimi dhe përfundimi; organizimi i zinxhirit të veprimtarive në një sekuencë logjike.

Aftësitë komunikuese: Formulimi i ideve gjatë fazës së skicimit dhe në fazën e prezantimit të produktit përfundimtar; përgatitja e skicave, diagramave, modeleve dhe fotografive, si dhe skicat dhe grafikët me anën e kompjuterit.

5. PROGRAMI I KLASËS SË GJASHTË SYNON T’I PAJISË NXËNËSIT ME:

- Njohuri teorike për bazën materiale, proceset e punës dhe teknikat në realizmin e një punimi.
- Aftësi për vëzhgimin e elementeve në një punim apo krijim; për përshkrimin dhe interpretimin e karakteristikave të punimit të kryer; për vlerësimin në bazë të njohurive të marra për punën e tyre apo të dikujt tjetër; për të bashkëpunuar, për të punuar në grup, për të dëgjuar dhe për të respektuar mendimin e shokut, duke u aftësuar për të zënë një pozicion dhe për të përdorur një sasi më të madhe informacioni apo baze materiale.
- Shkathësi për përdorimin e bazës materiale.
- Qëndrime për të qenë i pavarur gjatë një punimi; për të respektuar mendimin e tjetrit; për të marrë përgjegjësi për punën që po bëjnë.
- Vlera për respektimin e traditave dhe të zakoneve; realizimi i detyrave dhe i përgjegjësi.

PROGRAMI SINTETIK

35 javë x 1 orë = 35 orë

NJOHURI TË REJA - 12 ORË
PUNË PRAKTIKE - 16 ORË
DISPOZICION - 7 ORË

35 ORË

SHTRIRJA E PROGRAMIT SIPAS LINJAVE

SASIA E ORËVE SIPAS LINJAVE		
Linjat		ORËT
A	Njeriu dhe shoqëria në teknologji	2
B	Teknologjia e materialeve dhe proceseve	14
C	Strukturat, mekanizmat, forcat dhe energjia	10
D	Teknologjia e informacionit dhe komunikimi	2
	Në dispozicion	7
	Gjithsej	35

Siç shihet edhe nga tabela, mësimet zhvillohen me nga një orë në javë. Programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që për çdo lloj pune nxënësit të marrin njohuritë e para praktike dhe teorike për punimin e objekteve, të mjeteve mësimore të thjeshta.

Programi paraqet llojete punës të zërthyera e të gërshetuara duke marrë për bazë kohën më të përshtatshme për realizimin e çdo objekti dhe llojin e punës, që duhet punuar dhe njohuritë praktike e teorike që ka marrë nxënësi në orët e mëparshme. Mësuesi mund të zgjedhë atë që ai e gjykon më të përshtatshme për nxënësin dhe që realizon të gjitha kërkesat mësimore dhe edukative, duke i dhënë përparësi punëve praktike.

6. PËRMBAJTJA E LËNDËS SIPAS LINJAVE

Në këtë program njohuritë zgjerohen duke u përshkallëzuar nga klasa në klasë, duke realizuar kompaktësimin e kësaj lënde jo vetëm në drejtimin praktik, por edhe edukativ.

Programi ruan deri diku përmbajtjen e mëparshme. Njëkohësisht, ai synon të shmangë mbingarkesën dhe të ulë nivelin e vështirësive në disa linja, si dhe të realizojë një organizim dhe një shpërndarje më të mirë të orëve sipas linjave.

Njohuritë teknologjike klasifikohen në katër linja kryesore:

1. Teknologjia e materialeve dhe proceseve.
2. Strukturat, mekanizmat, forcat dhe energjia.
3. Teknologjia e informacionit dhe komunikimi.

4. Njeriu dhe shoqëria në teknologji.

Çështjet më të rëndësishme që propozohen për secilën linjë janë:

1. Teknologjia e materialeve dhe proceseve
Materialet: Burimet, tipat, teknikat e përpunimit, vetitë dhe mundësitë për përpunim, zbatimet në jetën e përditshme.
Mjetet dhe instrumentet: Mjetet e dorës, instrumentet elektrike, instrumentet mekanikë.
Teknikat e përpunimit dhe të prodhimit: Proceset, radha e punës, parimet.
2. Strukturat, mekanizmat, forcat dhe energjia.
Strukturat: Qendrueshmëria, tipat e strukturave të qendrueshme, shtypja, tërheqja, përkulja, përdredhja, këputja.
Burimet e energjisë: Dielli, era, uji.
Format e energjisë: Energjia mekanike, nxehtësia, drita, tingulli, elektriciteti.
Ruajtja e energjisë: Shfrytëzimi i energjisë, ruajtja e energjisë.
Mekanizmat: Mekanizmat për krijimin e lëvizjes drejtvizore dhe mekanizmat për krijimin e lëvizjes rrotulluese.
Makina të thjeshta: Makara, bosht rrotullues, tanxha e dorës, pajisje perçinimi etj.
Elektriciteti: Qarqet elektrike etj.
3. Teknologjia e informacionit dhe komunikimi.
Informacioni: Mbledhja e të dhënave, teknikat e përpunimit dhe transmetimit të të dhënave.
Matja: Teknikat e matjes, matja, markimi dhe instrumentet e kalibrimit.
Komunikimi: Komunikimi ndërmjet ngjyrave dhe formave, teknikat e paraqitjes grafike (vizatimit) dhe përdorimi i simboleve.
4. Njeriu dhe shoqëria në teknologji.
Mjedisi fizik e social i vendbanimit: Shtëpia, fqinjësia, qyteti/fshati.
Transporti: Mjetet e transportit, rrjeti rrugor.
Teknologjia ekologjike: Roli i teknologjisë ekologjike në shoqëri; të mirat e ekologjisë për individin dhe shoqërinë; ndikimi i koncepteve dhe prirjeve ekonomike, kulturore dhe estetike në produktet teknologjike; përfshirja e individit në marrjen e vendimeve që lidhen me mjedisin dhe që ndikojnë në cilësinë e jetesës.

7. VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësve u jep mësuesve informacionin e nevojshëm për t'u mbështetur në dhënien e njohurive në të ardhmen. Ai u lejon atyre të bëjnë krahasimin me arritjet e mëparshme, gjë që ofron kërkesa më cilësore për mësimdhënien. Ai ka për qëllim kryesor përmirësimin e cilësisë së të mësuarit dhe jo thjesht kontrollin apo diferencimin e nxënësve.

Mësuesit duhet të njohin aftësitë e grup-moshës përkatëse. Vlerësimi përqendrohet në përpjekjet dhe energjitë që nxënësit kanë derdhur në realizimin e punës së tyre. Mësuesi u drejtohet nxënësve me disa pyetje e kërkesave nxitëse:

- A u kënaqët duke bërë punimin tuaj?
- Ç'ju frymëzoi që të mendoni për këtë ide?
- A mendoni se e realizuat me kënaqësi idenë e punimit tuaj?
- Më flisni rreth krijimit tuaj.

Në vlerësimin e nxënësit, mësuesi mbështetet në atë sa i ka realizuar objektivat e temës përkatëse në krijimin e tij. Ky vlerësim bëhet me notë (në kolonë ose të shpërndara), duke u mbështetur në punimet e secilit nxënës.

Fakti që një punim është bërë nga një nxënës, nuk do të thotë se nuk ka merita apo vlera artistike. Vlera e tij qëndron në faktin se krijuesi i punimit shqetësohet për shprehjen e mendimeve, duke përdorur aftësitë në nxjerrjen e punimit me materialet që ai përdor.

Gjithashtu, vlerësimi i nxënësve mund të bëhet edhe në formën e një diskutimi të udhëhequr nga mësuesi, ku nxënësit gjatë ekspozimit të punimeve, analizojnë punën e njëri-tjetrit. Për këtë, xënësi duhet të vëzhgojë, të përshkruajë, të analizojë, të interpretojë dhe të vlerësojë punën e tij dhe të shokut.

Në mbarim të mësimit, organizohet vlerësimi dhe diskutimi në grup për çdo punë të kryer.

8. UDHËZIME METODOLOGJIKE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi është konceptuar në tërësi. Në të jepet sasia orientuese e orëve dhe çështjet kryesore që do të trajtohen.

Numri i orëve në çdo kapitull është përgjithësisht orientues. Në raste të veçanta kur mësuesi e gjykon të drejtë, mund të ndryshojë në kufij të pranueshëm, orët e caktuara për kapitullin në tërësi, duke huazuar nga kapituj të tjerë.

Mësuesi duhet ta zotërojë mirë lëndën, të zgjerojë vazhdimisht horizontin e tij shkencor e kulturor, të përsosë vazhdimisht metodat e mësimdhënies, të aktivizojë pa ndërprerje mendimin krijues të nxënësve, të punojë me durim, pasion e këmbëngulje.

Gjatë zhvillimit të mësimit është e domosdoshme:

- Të rrespektohen me përpikmëri parimet dhe rregullat didaktike.
- Në fillim të mësimit, nxënësve duhet t'u tregohet qëllimi konkret i punës.
- Të zhvillohen tek nxënësit aftësitë logjike për të punuar, duke i nxitur të arsyetojnë gjatë punës.
- Të edukohen nxënësit me shprehitë e një pune të kulturuar, për të ngulitur tek ta ndjenjën e përpikmërisë, të rregullit dhe të higjienës vetjake.
- Të tregohet rëndësi për organizimin e punës kolektive me nxënësit (bashkëpunimi).
- T'i kushtohet rëndësi e madhe krahasimit të mënyrave të punimit të një objekti në klasë dhe në prodhim për t'ua zgjeruar horizontin politeknik.
- Të organizohen edhe punë jashtë klase për rritjen e interesit të nxënësve për punë, për zgjerimin dhe thellimin e njohurive dhe shprehive të fituara.
- Shkolla duhet të ketë një minimum të caktuar pajimesh të nevojshme për kryerjen e të gjitha kërkesave për zhvillimin normal të lëndës, rëndësi ka njohja e prindërve me punën që bëjnë fëmijët e tyre.

Kujdes të tregohet edhe për paraqitjen e përshkallëzuar të detyrave praktike. Nxënësit e klasës së gjashtë kanë arritur të fitojnë shprehitë e para të punës gjatë

mësimeve në ciklin fillor. Në të gjitha mësimet të ruhet përshkallëzimi i kryerjes së proceseve të punës. Për tema të veçanta punimi i objektit mund të zgjatet edhe në dy orë mësimi, kur mësuesi e quan të domosdoshme.

Gjatë zhvillimit të lëndës të respektohen me përpikmëri parimet dhe rregullat didaktike që përdoren në mësimet e të gjitha lëndëve të tjera. Të përdoren metoda dhe forma të ndryshme pune: bashkëbisedimi, i shoqëruar me përgatitjen analitike të objekteve konkrete, paraqitja e mjeteve për kryerjen teknike të punës me vegla dhe ushtrime të shumta për të përvetësuar mënyrat e reja të punës. Me rëndësi është që nxënësit të mësohen të punojnë edhe në mënyrë të pavarur, sidomos në rastet kur proceset e punës janë të njohura nga ta. Si rregull, në fillim të mësimit nxënësve t'u tregohet qëllimi konkret i punës. Për këtë mësuesi u tregon nxënësve se çfarë objekti do të punohet, përse do të shërbejë ai, çfarë aftësish e shprehish do të fitojnë ata duke punuar këtë objekt. Nxënësve u tregohet objekti i gatshëm, pastaj i zbërthyer në pjesë dhe mënyrat e punimit. Më vonë nxënësit mësohen gradualisht të kuptojnë paraqitjen grafike të objektit dhe të lexojnë skica të thjeshta të objektit që punohet.

Për të zhvilluar te fëmijët aftësi logjike për të punuar, të nxiten të mendojnë dhe të arsyetojnë duke organizuar edhe diskutime në grup për mënyrat e punimit të objektit, çfarë materialesh dhe veglash nevojiten për punë, në ç'sasi, pse duhet vepruar kështu edhe u shpjegohet edhe për disa gabime që mund të bëjnë gjatë punës. Në rastin e demonstrimit të mbajtjes së trupit gjatë punës, mënyrat e përdorimit të mjeteve dhe të veglave të punës, është mirë të përdoren edhe mjete demonstruese në klasë. Për të siguruar nëse nxënësit i kanë kuptuar mirë veprimet e punës, është mirë të ngrihet ndonjë nxënës që të tregojë sesi do t'i kryejë këto. Në këtë rast mësuesi vë në dukje veprimet e mira të nxënësit, qorton gabimet e mundshme në përdorimin e veglave dhe udhëzon fëmijët për fillimin e punës.

Rëndësi të madhe ka zhvillimi te nxënësit i elementeve të shprehive të konstruktimit, zhvillimi i përfytyrimeve të hapësirës etj. Duhet ushtruar ata që sistematikisht të bëjnë matje të thjeshta, të verifikojnë përpjesëtimet, të studiojnë vendosjen reciproke të pjesëve të ndryshme të objektit që punohet.

Për të edukuar te nxënësit shprehitë e një pune të kulturuar, për të ngulitur tek ata ndjenjën e përpikmërisë, të rregullit e të higjinës vetjake, rëndësi ka përgatitja dhe rregullit në vendin e punës. Për çdo mjet pune dhe material, gjatë gjithë kohës së punës, caktohet vendi përkatës në tavolinë ose në bankë.

Gjatë punës së pavarur mësuesi ndihmon, duke kontrolluar me kujdes veprimtarinë çdo nxënësi, kërkon që ata të zbatojnë me përpikmëri udhëzimet e tij, të mbajnë trupin drejt gjatë punës, të përdorin drejt mjetet, të mbajnë pastër vendin e punës etj.

Rëndësi për këto mësimet ka dhe organizimi i punës me grupe. Ajo mund të organizohet në punimin e objekteve të zbulimit për festa, përgatitje mjetesh të thjeshta, meremetime të orendive të klasës, modelime, ndërtime të ndryshme shumëplanëshe, makete etj. Gjatë punës realizohet ndarja e saj ndërmjet nxënësve dhe ata bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, duke kryer punët që u ngarkohen dhe duke mbajtur përgjegjësi për punën e kryer.

Për t'i stërvitur nxënësit në kryerjen dhe përvetësimin e disa veprimeve të rëndësishme në punë ose në përdorimin e metodave të punës, mësuesi mund të japë herë

pas here edhe detyra shtëpie. Detyrat e shtëpisë jepen vetëm atëhere kur mësuesi është i bindur se nxënësi do t'i kryejë me forcat e veta.

Për të zgjeruar horizontin politeknik, rëndësi ka krahasimi i mënyrave të punimit të objekteve në klasë dhe në prodhim. Në këtë drejtim, vlerë të madhe kanë ekskursionet. Gjatë ekskursioneve, nxënësit njihen me punën e makinave dhe të mekanizmave të prodhimit; si ato lehtësojnë punën e njeriut; marrin njohuritë e para për mekanizmin e prodhimit, për metodat e punës së mekanizuar, rregullin në punë dhe për profesione të ndryshme etj.

Për rritjen e interesit të nxënësve për punë, për të zgjeruar dhe për të thelluar njohuritë dhe shprehitë e fituara, është mirë të organizohen edhe punë jashtë klase, si: në zbulimin e korridoreve të shkollës, të oborrit, të kujdesen për lulishten e shkollës, të zonës ku banojnë, të komunitetit etj.

Rëndësi të madhe ka dhe njohja e prindërve me punën e fëmijëve që realizojnë në klasë. Prindërit duhet të dinë për aftësitë dhe shprehitë që fitojnë fëmijët e tyre dhe së bashku me mësuesin të caktojnë llojet e punës që duhet të bëjnë fëmijët në shtëpi, si vetëshërbimi, mirëmbatja e mjedisit familjar dhe ndihma në punët e shtëpisë. Llojet e këtyre punëve duhet të shtohen nga klasa në klasë, sipas vështirësive dhe vlerës së tyre edukative. Ndjekja e tyre në mënyrë sistematike nga mësuesi dhe prindërit, është kusht i domosdoshëm për edukimin e shprehive dhe qëndrimin e ndërgjegjshëm ndaj çdo lloji pune. Me nxënësit nuk duhet të bëjmë dallime për punë që kryejnë vajzat dhe për punë që kryejnë djemtë, kështu që në këtë moshë krijohen mundësi për barazinë e gruas me burrin.

9. LIDHJET NDËRLËNDORE ME JETËN DHE MJEDISIN

Rëndësi të madhe ka që lënda të lidhet edhe me mësimet e lëndëve të tjera. Kështu, gjatë një punimi, nxënësi mund të krijojë duke bërë ndërthurjen me elemente të artit pamor, me muzikën apo me aktrimin. Gjatë zhvillimit të edukimit teknologjik, mund të zbatohen, të konkretizohen dhe të përforcohen njohuri, shprehi, aftësi të marra në lëndë të tjera, si: matematika, artet figurative, dituri natyre etj. Ndërkohë, aftësitë që nxënësit fitojnë, mund të përdoren edhe në mësimin e lëndëve të tjera.

Nxënësit bëhen njohës dhe përdorues jo vetëm të bazës materiale, por edhe të teknikave të ndryshme e të shumëllojshme të proceseve të zbatimit të tyre. Duke u familjarizuar me to, ata do të jenë në gjendje që t'i përdorin ato për zgjedhjet e tyre artistike dhe për të komunikuar ndjenja dhe mendime.

Është gjithmonë e rëndësishme të theksohen shprehitë e mira të sigurisë. Në të gjithë veprimtarinë gjatë këtyre mësimëve, është e domosdoshme që mësuesi, në përshtatje me temën a punën që do të kryhet, të japë edhe rregullat përkatëse të sigurimit teknik. Nxënësit nxiten të zbatojnë disa rregulla sigurie, të cilat afishohen në këndin e punës së klasës.

II. KRITERE PËR HARTIMIN E TEKSTEVE TË LËNDËS SË EDUKIMIT TEKNOLOGJIK

Teksti i lëndës së edukimit teknologjik synon të sjellë në klasë, në miniaturë, mjedisin e aftësimin praktik të nxënësit, ku ata jetojnë e punojnë. Ai të krijojë lidhje të fuqishme bashkëpunimi krijues: nxënës - nxënës, mësues - nxënës, mjedis shkollor e jashtëshkollor.

PARIME TË PËRGJITHËSHME TË HARTIMIT TË TEKSTIT

1.- Teksti i lëndës së edukimit teknologjik, si libër shkollor, të jetë në përputhje me programin konkret të miratuar nga MASH. Ai të përmbushë të gjithë objektivat mësimorë e pedagogjikë që përmbahen në të. Në këtë mënyrë teksti t'u përmbahet qëllimeve të sistemit arsimor, në përgjithësi, dhe të programit, në mënyrë të veçantë. Kjo gjë nënkupton mbajtjen parasysht të qëllimeve në dy nivele:

a) të qëllimeve të shprehura hapur në program. Pra, në tekst të përfshihen ato informacione dhe të mundësohen ato veprimtari, të cilat synojnë të arrijnë qëllimin e shprehur në program;

b) të qëllimeve të nënkuptuara. Autorët e teksteve të studiojnë dhe të zbulojnë atë sistem vlerash, në të cilat mbështetet një sistem arsimor demokratik. Teksti nga ana e tij, si i tërë, të mundësojë realizimin e qëllimeve të tilla, të cilat në shumë raste janë edhe themelore.

2. Teksti nuk është thjeshtë përkthim i programit, që ka karakter sa detyrues aq edhe udhëzues, por përdoret për studim vetjak. Autorët, duke patur një konceptim të qartë të procesit mësimor dhe të perceptimit të tyre për përmbajtjen e lëndës, mund të kthehen në një faktor nxitës në mësimdhënien e lëndës së edukimit teknologjik. Në këtë drejtim autorët mund të shfrytëzojnë:

a) hapësirat e programit (lëvizshmërinë e temave, orët në dispozicion ose përsëritjet)

b) aparatin pedagogjik të tekstit, i cili më shumë se çdo tjetër kufizon ose zgjeron mundësitë e përvetësimit të objektivave të lëndës.

3. Ndërtimi i tekstit të niset nga parimi se nxënësi fiton njohuri nga veprimtaria e tij praktike, nëpërmjet pjesëmarrjes në procese të thjeshta pune. Hartuesit e tij të krijojnë kushte të tilla që nxënësi të veprojë duke u nxitur nga sa më shumë fusha ndijore dhe veçanërisht mendore. Vetëm kështu nxënësi merr njohuri të zbatueshme.

4. Të gjenden zgjidhje të frytshme në tekst që mësuesi të përçojë njohuritë në mënyrë sa më të saktë.

5. Të mbështetet në kërkesat didaktike të shkollës së sotme, duke përcjellë dhe përvojën bashkëkohore.

TEKSTI SHKOLLOR

Teksti shkollor të mundësojë realizimin e objektivave në fushën e njohurive, të shprehive dhe të qëndrimeve.

Kjo do të thotë që teksti duhet të ofrojë, si për nxënësit ashtu edhe për mësuesit, krijimin e situatave mësimore që mundësojnë realizimin e objektivave të mësipërm. Këtu duhet të kujtojmë se veprimtaritë praktike nuk mund të shihen të ndara nga veprimtaritë krijuese.

- Është mirë që nxënësit të aktivizohen më parë në veprimtari praktike të tilla, si: vëshgimi, grumbullimi i matërishtit paraprak, biseda, vizitat në ekspozita, qendra pune, vende me arkitekturë të veçantë, shikim filmash, vizita në ndërmarrje prodhimi.
- Sistemimi i dijeve në tema e në nëntema që t'i ndihmojë nxënësit të zbërthejnë faktet nëpërmjet ushtrimit dhe të caktohen në tekst burime të tjera të informacionit,

USHTRIMET TË JENË TË TILLA:

- ndijore (me albume modelesh, me punime të ndryshme të nxënësve, me tabela, me video, me filma).

- veprimtari praktike (me një bazë të caktuar materiale, si dhe me një teknikë të caktuar).
- veprimtari shprehëse (me shkrim, me gojë, me krijim vetjake).
- veprimtari mendore (analiza, veçimi, krahasimi, dallimi, sinteza, klasifikimi, përgjithësimi, zgjerimi i argumentit), nxjerrja e përfundimit etj.

Ushtrimet të planifikohen të tilla që të përforcojnë përmbajtjen, të kenë material njohës e ilustrues. Veprimtaria ndijore të përfshijë ilustrimet me punime të ndryshme të nxënësve. Për këtë arsye është mjeshtëria e autorit të tekstit që të parashikojë ato veprimtari që mundësojnë realizimin në tërësinë e tyre të synimeve dhe të objektivave të lëndës.

4) Sistemi i pyetjeve në fund të njësisë mësimore të ofrojë mundësinë (autorët mund të përdorin edhe forma të tjera):

Që nxënësit:

- në mënyrë të pavarur të përvetësojë informacionin e tekstit;
- të dallojnë atë çka është thelbësore nga ajo që nuk është e tillë, në varësi të objektivave të njësisë mësimore dhe të objektivave të programit;
- të përfshihet në veprimtari krijuese që synojnë të zhvillojnë aftësitë praktike dhe krijuese etj;
- të krijojnë mendimin dhe qëndrimet e tyre të pavarura, të mbështetura me argumente, por të pranojnë, të respektojnë dhe të marrin parasysh argumentet e të tjerëve.

Që mësuesit:

- të zgjedhin metodat ndërvepruese më të përshtatshme për realizimin e objektivave të lëndës së edukimit teknologjik;
- të planifikojnë më mirë orën e mësimi;
- të mundësojnë vënien e nxënësve në kushte të barabarta të nxëni;
- të mundësojnë nxënësit të përqendrohen në çështjet kryesore të temës mësimore;
- të mundësojnë nxënësit të shfrytëzojnë njohuritë e tyre paraprake ose të përvetësuara gjatë procesit mësimor që janë të domosdoshme për përvetësimin e njohurive dhe të shprehive të reja;
- të vlerësojnë realizimin e objektivave të njësive mësimore dhe nivelet e përvetësimit të tyre nga nxënësit etj.

5) Teksti të përmbajë mësim ose struktura mësimi të qarta, në formën e njësive mësimore, për të arritur objektiva të qartë mësimore në përputhje me programin e dhënë ose me standardet lëndore.

6) Po kështu, në tekst mund të shfrytëzohet ose të nxitet edhe mundësia e marrjes së informacioneve të caktuara shtesë nga burime të tjera informacioni (tekste, shembuj didaktikë, foto të modeleve mësimore, ekspozita, punime të fëmijëve bashkëmoshatarë apo më të rritur, pamje të ndryshme të përdorimit të prodhimeve artizanale në mjediset familjare, në punë, shkollë, në zbulimin e mjedisit me mjete të krijimit me dy e tri përmasa dhe ndikimet e tyre në jetën e njeriut), gjë që do të bënte tekstin ose njësine mësimore më të hapur dhe më pak monotone, duke rritur edhe mundësitë e punës së pavarur vetjake kërkimore të nxënësve.

5) Gjuha e teksteve të jetë e thjeshtë, e kuptueshme, e pangarkuar me terma e terminologji në gjuhë të huaja ose që bartin kuptime të ndryshme.

6) Nëse në tekst përdoren ilustrime, ato të bartin vlera kuptimore dhe emocionale që lidhen ngushtë me motivimin e nxënësve, me përmbajtjen e njësisë mësimore ose me objektiva të tjerë të programit.

7) Nga pikëpamja sasiore, autorët e teksteve të shmangin informacionet e tepërta, të përsëritura etj., që shpesh krijojnë mbingarkesë tek nxënësit, të cilët jo gjithmonë janë në gjendje të dallojnë informacionin kryesor nga ai që nuk është i tillë në raport me kërkesat e programit ose të njësisë mësimore. Autorët të bëjnë kujdes që të mos krijojnë mbingarkesë edhe në dhënien e koncepteve. Mbingarkesa krijohet jo vetëm nga numri i madh i koncepteve që jepen në një njësi mësimore, por edhe nga pamundësia e sqarimit të tyre në kushtet e kufizimit sasior (informacionit) dhe kohor të njësisë mësimore. Informacionet shpesh (ilustrimet, fotot, tekstet, grafikët, shembujt didaktikë të edukimit teknologjik t'i shërbejnë sqarimit më të mirë të koncepteve.

8) Njësi mësimore e tekstit të ketë një strukturë që të lejojë përmbushjen e funksioneve të tekstit, si dhe pasqyrimin e veçorive të përmbajtës së temave të veçanta, p.sh., mësimet përsëritëse mund të hartohen të tilla që të japin një përsëritje ilustrative të konceptit apo të hartuar në formën e një kërkesë për një mjet përdorimi. Mësimet për vlerësimin praktik të kenë një model dhe kritere të vlerësimit, pyetësorë për nxitjen e mendimit.

9) Struktura e ndarjeve të tekstit, si dhe struktura e njësisë mësimore të tekstit (p.sh., tema) të jenë të njësuara gjatë gjithë tekstit.

10) Faqosja e elementeve të ndarjeve mësimore (titujt, tekstet, modelet, ilustrimi figurativ, pyetësori, modelet, gjëza figurative etj.) të jenë tërheqëse dhe të mbështetura në procedurën logjike të shtjellimit të lëndës, në përgjithësi, dhe të temës, në veçanti.

11) Përdorimi i hapësirave, nënvizimeve, sqarimeve, ngjyrave etj., të jetë në shërbim të çështjes që trajtohet.